



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë më 20.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

I. HYRJE

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjet e datave 6,7, 19 dhe 20 nëntor, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në parim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar”, propozuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenet 78, 81, 82, 83, pika 1 dhe 155, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe që shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit. Ky projektligj është pjesë e Paketës Fiskale së bashku me projektligjet e tjera që shoqërojnë projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019”.

Në mbledhjet e Komisionit ishin të pranishëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, Ministri i Financave dhe Ekonomisë z.Arben Ahmetaj dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie si dhe Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko.

II. QËLLIMI

Ky projektligj ka si qëllim rishikimin e dispozitave të ligjit që rregullon tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin në Republikën e Shqipërisë. Ndryshimet dhe shtesat propozohen jo vetëm për të përmirësuar procedurat e mbledhjes së tatimit, por edhe për të vazhduar më tej politikën e lehtësimit të barrës fiskale për kategori të veçanta si dhe për të mbrojtur bazën tatimore në vendin tonë.

III. NDRYSHIMET E PROPOZUARA

Nisma e propozuar nga Këshilli i Ministrave për ndryshimin e legjislacionit të tatimit mbi të ardhurat, përmban dispozitat e mëposhtme:

- Në nenin 1, të projektligjit propozohet të riformulohen dispozitat e nenit 4 “Burimi i të ardhurave”, të ligjit, që lidhen me të ardhurat nga pronësia dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e paluajtshme duke zgjeruar bazën e tatueshme në vend, nëpërmjet përfshirjes në këtë kategori edhe të të ardhurat nga të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, hidrokarbure apo burimeve natyrore tokësore dhe ujore si dhe aksioneve ose interesave të ngjashme me to.
- Në nenet 2, 7 dhe 8, të projektligjit propozohet lehtësimi i barrës fiskale për 20 mijë biznese ose mbi 50 mijë investitorë të kapitalit mëpërmjet uljes së normës së tatimit mbi dividendin, të ardhurave që rrjedhin si fitim i ortakut dhe nga ndarja e fitimit nga 15% në 8%.
- Në nenin 4, të projektligjit propozohet mosnjohja si shpenzime të zbritshme në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, të shpenzimeve për dieta që tejkalojnë 50% të fondit të pagës bruto vjetore, edhe kjo masë në kuadër të angazhimeve për minimizimin e shmangieve dhe ruajtjen e bazës së tatueshme.
- Në nenin 5, të projektligjit propozohet të shtohet një nen i ri në ligjin aktual, i cili i vendos detyrim personin juridik për të paguar tatimin mbi fitimin, në rastin e ndryshimit më shumë se 20% në vlerë, të pronësisë direkte dhe/ose indirekte të kapitalit aksionar, kuotave ose të drejtave të votimit, njoftimin e administratës tatimore brenda 45 ditëve për detajet e ndryshimit si dhe përjashtimin nga pagimi i tatimit për çdo ndryshim. Gjithashtu, në këtë nen vendoset detyrimi për njoftimin e administratës tatimore brenda 45 ditëve edhe për ndryshimet e pronësisë prej 10% ose më shumë të kapitalit ose të drejtave të votës të personit juridik, duke përcaktuar më pas edhe aplimin e penaliteteve konform ligjit të procedurave tatimore për rastet e mosnjoftimit.
- Neni 6, propozon shtimin e një neni të ri për përfshirjen e personave jorezidentë në personat që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin për fitimet e realizuara nga shitja e aksioneve apo interesave të ngjashme, vlera e të cilave buron nga pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë. Këto individë pastaj do të detyrohen të plotësojnë deklaratën e të ardhurave të tatueshme, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.
- Ndërsa me ndryshimin e pasqyrës nr.1 të ligjit realizohet ulja e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, që tatohen me normën 13%, nga 130.000 lekë/muaj në 150.000 lekë/muaj, nga e cila do të përfitojnë rreth 15.400 punëmarrës shumica e të cilëve punojnë në sektorin privat. Kjo ulje e tatimit shoqërohet edhe me disa ndërhyrje në ligjin e procedurës tatimore, me qëllim limitimin e abuzimeve me shmangien tatimore në pagat e larta.

Megjithatë, vlen të theksohet se ndryshimet në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, përfshijnë edhe reforma të qenësishme të kuadrit rregullator fiskal, siç ishin ndryshimet e miratuara në korrik të këtij viti, që parashikojnë:

- Uljen e tatim fitimit nga 15% në 5% për tatimpaguesit me qarkullim nga 8 milionë deri në 14 milion lekë, që janë rreth 10,850 biznese, ose gjysma e bizneseve që paguajnë tatim fitimin;
- Uljen e tatim fitimit nga 15% në 5% për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, të cilat operojnë sipas ligjit nr.38/2012. Ky ndryshim vjen në vazhdimësi të ndryshimeve të tjera që kanë përfituar gjatë këtij viti këto shoqëri siç është dhe rimbursimi i TVSH-së në masën 20 %, apo subvencionimi, investimi në kullim dhe ujitje dhe asistenca financiare e BE-së e dhënë nëpërmjet IPARD;
- Zhvillimin e sektorëve të veçantë të turizmit, siç është dhe agroturizmi për të cilën është propozuar aplikimi i një norme të reduktuar të tatim fitimit në masën 5 %, për një periudhë 10 vjeçare. Ndryshimin e sipërpërmendur do e përfitojnë të gjithë ato struktura akomoduese të cilat do të përfitojnë statusin “subjekt i çertifikuar agroturizmi” nga 1 janari 2019 deri më 31 dhjetor 2021;

IV. EFEKTET FINANCIARE

Reduktimi i tatimit mbi dividendin në 8% vlerësohet të ketë impakt pozitiv në të ardhurat buxhetore të vitit 2019 me rreth 4.5 miliardë lekë, si rrjedhojë edhe e përcaktimit të bërë në dispozitat kalimtare për aplikimin e normës së reduktuar për fitimet e paspërndara por të akumuluar apo të kapitalizuara të viteve të kaluara. Ndërsa zgjerimi i fashës së të ardhurave që tatohen me normën 13% do të rezultojë me një efekt negativ në buxhetin e shtetit prej 319 milion lekësh.

V. DISKUTIMET NË KOMISION

Diskutimet në Komision u fokusuan në propozimin nga ana e anëtarëve të Komisionit të uljes së ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, që tatohen me normën 0%, nga 30.000 lekë/muaj në 400.000 lekë/muaj.

Propozim tjetër ishte edhe rishikimi i normës tatimore për të ardhurat bruto nga loja, për kategoritë e lojërave të fatit “Kazino”/ “Kazino në hotele me 5 yje” dhe “Resort kazino” nga 15% në 30%.

Gjithashtu, nga anëtarët e Komisionit pati edhe propozime që kishin të bënin me uljen e tatimit mbi dividendin, duke sugjeruar rishikimin dhe njëherë të kësaj politike, nëpërmjet vendosjes së një norme të re të tatimit në nivelin 0% për të gjithë dividendin e riinvestuar, i cili mendohet se do të ndikojë drejtëpërsëdrejti në rritjen dhe zgjerimin e aktivitetit të kompanive.

Ndërsa, në seancën dëgjimore me Bankën e Shqipërisë, nga ana e Guvernatorit z.Gent Sejko u vlerësua fakti se paketa fiskale e këtij viti, nuk parashikonte ndryshime rrënjësore në sistemin tatimor duke nxitur qëndrueshmërinë e sistemit dhe ndikuar pozitivisht në përmirësimin e klimës së biznesit për investitorët vendas dhe të huaj. Nga ana e përfaqësuesve të Banka e Shqipërisë u vlerësua fakti se reduktimi i propozuar i taksës mbi dividendin, nga niveli 15% në nivelin 8%, krijon premisa për uljen e kostos së financimit me kapital për bizneset shqiptare, duke i shërbyer potencialisht nxitjes së investimeve vendase dhe të huaja, përmirësimit të strukturës dhe rritjen e qëndrueshmërisë së bilancit të bizneseve.

VI. PËRFUNDIME

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni duke vlerësuar se ndryshimet e propozuara tani sëbashku me ndryshimet e miratuara në korrik parashikojnë lehtësira fiskale të qenësishme për zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë shqiptare, që do të garantojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke siguruar punësim dhe më shumë të ardhura e më shumë mirëqenie për qytetarët shqiptarë, vendosi miratimin në parim të projektligjit me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORE

KRYETARI

Blerina GJYLAMETI

Erjon BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë më 27.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8438,
DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR
(shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi)**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjet e datave 26 dhe 27 nëntor 2017, shqyrtoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar. Projektligji është pjesë e paketës së projektligjeve financiare që shoqërojnë projektbuxhetin 2019.

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi u zhvillua pas miratimit në parim të këtij projektligji në seancën plenare të datës 22 nëntor 2017. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrtoi këtë projektligj bazuar në nenet 32-38 si dhe nenet 80 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit të datës 26 nëntor ishin të pranishëm përfaqësues nga shoqatat e biznesit si Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë në Shqipëri, *Dhoma Gjermane e Tregtisë* dhe Industrisë në Shqipëri dhe Biznes Albania. Ndërsa, në mbledhjen e datës 27 nëntor ishin të pranishëm Ministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

Ndryshimet dhe shtesat e propozuara nga Këshilli i Ministrave për ndryshimin e legjislacionit të tatimit mbi të ardhurat, përmban dispozitat e mëposhtme:

- *Zgjerimi i bazës së tatueshme në vend, nëpërmjet përfshirjes në tatimin mbi të ardhurat edhe të të ardhurave nga të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, hidrokarbure*

apo burimeve natyrore tokësore dhe ujore si dhe aksioneve ose interesave të ngjashme me to si dhe përfshirjen e personave jorezidentë në personat që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin për fitimet e realizuara nga shitja e aksioneve apo interesave të ngjashme, vlera e të cilave buron nga pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë.

- Lehtësimi i barrës fiskale për 20 mijë biznese ose mbi 50 mijë investitorë të kapitalit mëpërmjet uljes së normës së tatimit mbi dividendin, të ardhurave që rrjedhin si fitim i ortakut dhe nga ndarja e fitimit nga 15% në 8%.*
- Ulja e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, që taten me normën 13%, nga 130.000 lekë/muaj në 150.000 lekë/muaj, nga e cila do të përfitojnë rreth 15.400 punëmarrës shumica e të cilëve punojnë në sektorin privat. Kjo ulje e tatimit shoqërohet edhe me disa ndërhyrje në ligjin e procedurës tatimore, me qëllim limitimin e abuzimeve me tatimore në pagat e larta.*

Reduktimi i tatimit mbi dividendin në 8% vlerësohet të ketë impakt pozitiv në të ardhurat buxhetore të vitit 2019 me rreth 4.5 miliardë lekë, si rrjedhojë edhe e përcaktimit të bërë në dispozitat kalimtare për aplikimin e normës së reduktuar për fitimet e pashpërndara por të akumuluar apo të kapitalizuara të viteve të kaluara. Ndërsa zgjerimi i fashës së të ardhurave që taten me normën 13% do të rezultojë me një efekt negativ në buxhetin e shtetit prej 319 milion lekësh.

Përfaqësuesit e shoqatave të biznesit e vlerësuan në terësi Paketën Fiskale dhe sidomos zgjerimin e fashës së individëve që taten me shkallën 13% dhe uljen e dividendit në 8%. Megjithatë, përfaqësues të Dhomës Amerikane të Tregtisë ishin të mendimit se rishikimi i politikës së dividendit, do të ishte më efikas nëse aplikohet një shkallë tatimi në masën 0% me kushtin e riinvestimit të tij.

Në përfundim të mbledhjes, Komisioni e miratoi projektligjin nen për nen dhe në terësi me 10 vota pro dhe një votë kundër, me ndryshimet e mëposhtme:

- Pas nenit 4, shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Në fund të nenit 24 “Borxhet e këqia”, shtohet shkronja c) me këtë përmbajtje:

“c) në rast se pasuria e luajtshme ose e paluajtshme që siguron kredinë, ekzekutohet para afatevetë përcaktuara në shkronjat a) dhe b) më lart, provizionet e mëparshme bankare, të njohura si shpenzime të zbritshme, do të vazhdojnë të njihen si të tilla.”

- Në nenin 5, pika 1, e nenit 27/1 që propozohet të shtohet, pas shkronjës b), shtohet paragrafi më këtë përmbajtje:

“Paragrafi i parë, aplikohet në rastet kur personi juridik, për tre vitet paraardhëse ka realizuar një mesatare qarkullimi prej 500 000 000 (pesëqindmilionë) lekë.”

RELATORE

KRYETARI

Blerina GJYLAMETI

Erjon BRAÇE